



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 298

Ora: 12:00

VENDIM

**MBI PROCESIN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KRYETARËT E DISA BASHKIVE, PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

**OBJEKT:** Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, për koalicionin "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Subjektet zgjedhore, në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat për kryetar bashkie. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie dhe anëtarë në këshillat bashkiakë

Data: 5.4.2023 Nr: 298  
Ora: 12:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

rezulton se, të dhënat e deklaruara nga kandidatët nuk përfshihen në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me shkronja nistore “BF”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionet përkatëse për të gjithë kandidatët, bazuar në udhëzimin nr. 1. datë 18.01. 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të kandidatëve për kryetarë bashkie rezulton se asnjë e dhënë nuk është në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga ligji. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat për kryetar bashkie dhe kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie rezulton se, nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 dhe janë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja “b” e 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatët për kryetar bashkie që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për kryetar bashkie, sipas së cilës rezulton se kandidatët nuk janë në kushtet e ndalimit dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, edhe pse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është nisur lista për verifikim, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga kandidatët për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ-të duhet të vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

## PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 33, shkronja “f” i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja “a”, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit, për kandidatët për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për bashkitë sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

## Koalicioni "Bashkë Fitojmë"

NR.	BASHKIA	KANDIDATI
1	Bashkia Dimal	Gentian Meçi
2	Bashkia Kuçovë	Lefter Maliqi
3	Bashkia Poliçan	Behar Xhaferaj
4	Bashkia Skrapar	Euglen Mustafallari
5	Bashkia Bulqizë	Defrim Fiku
6	Bashkia Dibër	Ismail Uka
7	Bashkia Klos	Bedri Hoxha
8	Bashkia Mat	Skënder Gjuci
9	Bashkia Krujë	Agron Loka
10	Bashkia Belsh	Bedri Qypi
11	Bashkia Cërrik	Servet Duzha
12	Bashkia Gramsh	Hasim Çekrezi
13	Bashkia Librazhd	Shefki Çota
14	Bashkia Peqin	Mustafa Pashja
15	Bashkia Divjakë	Aurel Malko
16	Bashkia Mallakastër	Resmi Shanja
17	Bashkia Patos	Sofie Alushaj
18	Bashkia Roskovec	Erdit Hazizaj
19	Bashkia Dropull	Thanas Maneka
20	Bashkia Gjirokastër	Dorjan Lani
21	Bashkia Këlcyrë	Arjan Kasaj
22	Bashkia Libohovë	Adil Xhelili
23	Bashkia Memaliaj	Albert Malaj
24	Bashkia Përmet	Edmond Komino
25	Bashkia Tepelenë	Baftjar Imeri
26	Bashkia Devoll	Elvis Hajdërlli
27	Bashkia Kolonjë	Et'hem Lumani
28	Bashkia Maliq	Alfred Gega
29	Bashkia Pogradec	Zini Tollozhina
30	Bashkia Pustec	Pandi Jani
31	Bashkia Has	Miftar Dauti
32	Bashkia Kukës	Admir Sinamati
33	Bashkia Tropojë	Besnik Dushaj
34	Bashkia Kurbin	Behar Haxhiu
35	Bashkia Fushë-Arrëz	Hil Curri
36	Bashkia Malësi e Madhe	Isa Ramaj
37	Bashkia Vau-Dejës	Zef Hila
38	Bashkia Kavajë	Fisnik Qosja
39	Bashkia Vorë	Indrit Hoxha



40	Bashkia Delvinë	Ilir Mehmeti
41	Bashkia Finiq	Leonidha Hristo
42	Bashkia Himarë	Dhionisios Alfred Beleri
43	Bashkia Konispol	Fatmir Shero
44	Bashkia Sarandë	Ardit Çikuli
45	Bashkia Selenicë	Leonard Rakipaj
46	Bashkia Mirditë	Albert Mëlyshi
47	Bashkia Prenjas	Suzana Topi
48	Bashkia Pukë	Rrok Dodaj
49	Bashkia Shijak	Rezeart Tusha
50	Bashkia Rrogozhinë	Shkëlqim Hoxha